

Shefi i NATO-s:
Nevojitet një dialog i
matur për Ukrainën



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MES KËRCËNIMEVE E DEBATEVE TË ASHPRA KQZ-ja MIRATON BUXHETIN PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar të martën planin e buxhetit për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 28 dhjetor 2025. Buxheti i miratuar për këto zgjedhje është 11,493,526 euro, ndërsa kostoja fillestare e planifikuar ishte 7,771,486 euro. Rritja e buxhetit përfundimtar u bë për shkak të miratimit të amendamentit që parasheh dërgimin e pakove me fletëvotime përmes postës për votuesit që janë regjistruar për të votuar jashtë vendit

**SHPËRTHIMI
NË IBËR-LEPENC,
NJË VIT MË
VONË: AS
AKTAKUZË, AS
PËRGJEGJËSI** F. 3



**"ËSHTË NË DUART
E GJYQITARËVE":
SPECIALJA PA DATË
KONKRETE PËR
VENDIMIN NDAJ
ISH-EPRORËVE
TË UÇK-së** F. 3



**PLANI AMERIKAN KUNDËR
ATIJ EVROPIAN, DY VIZIONE
TË KUNDËRTA PËR PAQEN NË
UKRAINË** F. 2

**LDK-ja E NOMINON ABDIXHIKUN
KANDIDAT PËR KRYEMINISTËR** F. 3

EKONOMI



**IKJA E KAPITALIT:
INVESTIMET JASHTË KOSOVËS
RRITEN PËR 55%** F. 7

**HEKURUDHA E RE NË
MAQEDONINË E VERIUT, NJË
AMBICIE PREJ 1.9 MILIARD
EUROSH** F. 7

SPORT



**AFRIM TOVËRLANI EMËROHET
TRAJNER I PRISHTINËS** F. 11

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

PLANI AMERIKAN KUNDËR ATIJ EVROPIAN, DY VIZIONE TË KUNDËRTA PËR PAQEN NË UKRAINË

UASHINGTON, 25 NËNTOR - Propozimi prej 28 pikash i administratës Trump për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë është kritikuar si shumë i favorshëm për Rusinë. Ndërkohë, kundërpropozimi evropian, është shumë më në përputhje me dëshirat e Ukrainës, shkruan CNN.

Për lëshimet territoriale: Plani i ShBA-së thotë se Luhansku, Donetsk dhe Krimea e pushtuar do të njihen de facto si territore ruse, përfshirë edhe nga Shtetet e Bashkuara. Ai gjithashtu thotë se Kherson dhe Zaporizhzhia do të ngrihen përgjatë vijës së kontaktit. Drafti evropian ndryshon rrënjësisht, sipas versionit të siguruar nga Reuters. Teksti thotë: "Ukraina zotohet të mos e rimarrë territorin e saj të pushtuar sovran me mjete ushtarake. Negociatat për shkëmbimet territoriale do të fillojnë nga Vija e Kontaktit."

Mbi zgjerimin e NATO-s: Drafti i planit amerikan përfshin një dispozitë që NATO nuk do të

zgjerohet më tej dhe përcakton që Ukraina do të bjerë dakord të mos bashkohet me NATO-n. Drafti evropian i heq këto dispozita, duke thënë se "bashkimi i Ukrainës me NATO-n varet nga konsensusi i anëtarëve të NATO-s". Ai vëren se konsensusi aktualisht nuk ekziston, por gjuha e përdorur e lë derën hapur.

Mbi ushtrinë e Ukrainës: Plani i ShBA-së vëren se Forcat e Armatosura të Ukrainës "do të kufizohen në 600,000 persona". Plani evropian sugjeron që ushtria ukrainase është "e kufizuar në 800,000 në kohë paqeje". Në të dyja draftet, ushtrisë shumë më të madhe të Rusisë nuk i kërkohet të bëjë shkurtime.

Për zgjedhjet e ardhshme: Drafti i ShBA-së gjithashtu kërkon që Ukraina të mbajë zgjedhje brenda 100 ditëve nga një marrëveshje e nënshkruar - diçka që analistët thonë se do të ishte një dritare jopraktikisht e shkurtër për të lejuar fushatën.



Drafti evropian thotë vetëm se zgjedhjet duhet të mbahen "sa më shpejt të jetë e mundur" pas nënshkrimit të një marrëveshjeje. Kujtojmë se ekzistojnë disa versione të tjera të tekstit evropian që janë raportuar në

mediat amerikane dhe britanike, të cilat ndryshojnë nga kopja që siguroi Reuters. Plani amerikan me 28 pika mund të ketë evoluar gjithashtu që nga versioni i tij original pas diskutimeve të udhëheqësve të lartë në Gjenevë.

Sekretari i Ushtrisë Amerikane, Dan Driscoll, zhvilloi takime me zyrtarë rusë në Abu Dhabi dhe në lidhje me një plan të propozuar për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë, tha një zyrtar amerikan për CNN.

SHEFI I NATO-S: NEVOJITET NJË DIALOG I MATUR PËR UKRAINËN

BRUKSEL, 25 NËNTOR - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se propozimi amerikan për paqe ka ndihmuar që Kievi dhe Uashingtoni të afrohen drejt përfundimit të luftës mes Rusisë dhe Ukrainës - konfliktit më të madh dhe më vdekjeprurës në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore.

Duke folur në një intervistë për Radion Evropa e Lirë nga selia e aleancës në Bruksel më 24 nëntor, Rutte e përshkroi si "shumë të suksesshëm" rundin e bisedimeve të zhvilluar gjatë fundjavës për propozimin e Uashingtonit.

Ky rund u mbajt në Gjenevë mes negociatorëve ukrainas dhe amerikanë. "Qartësisht, disa nga elementet duhet të shqyrtohen me maturi", tha Rutte për planin 28-pikësh, duke shtuar se "qartësisht, si bazë, ai i shërbeu qëllimit të vet dje, duke i sjellë dy palët në një dialog të vërtetë".

Plani, që u publikua nga disa media, ndezi alarmin në disa kryeqytete evropiane, por edhe në Kiev, me disa që e quajtën atë si "listë dëshirash" të Kremlinit.

Kushtet e përfshira në të kërkonin lëshime të gjera nga Kievi dhe dukeshin se pasqyronin shumë nga kërkesat e Kremlinit, përfshirë dorëzimin e rajoneve Donjeck dhe Luhansk të Ukrainës - që njihen si Donbas dhe Krimenë, si dhe vendosjen e kufizimeve për madhësinë e ushtrisë së Ukrainës.

Propozimi do t'i lejonte po ashtu



Moskës të rikthehej në Grupin e Shtatë vendeve më të industrializuara (G7), si dhe do të lehtësonte gradualisht sanksionet perëndimore ndaj Kremlinit.

Teksa propozimi u bë publik, diplomatët evropianë ngarendën të hartonin një kundërpropozim më të favorshëm për Kievin.

Shefi i NATO-s, Mark Rutte, tha se "elementet që lidhen më shumë me BE-në ose NATO-n do të diskutohen ndaras".

Presidenti amerikan, Donald Trump, fillimisht i dha Ukrainës afat deri më 27 nëntor për të rënë dakord mbi propozimin, megjithëse më vonë e zbuti afatin.

Nuk ka deklarata publike mbi bisedimet se si plani i rishikuar do të trajtojë çështjet sikurse garancitë e sigurisë për Ukrainën ndaj kërcënimeve të ardhshme ruse apo mënyrën se si do të

financohej rindërtimi i Ukrainës pas luftës.

Rutte konfirmoi se ka qenë në kontakt si me Trumpin ashtu edhe me presidentin ukrainas, Volodymyr Zelensky, gjatë fundjavës dhe ishte i rezervuar për të diskutuar propozimin pikë për pikë.

Por, ai theksoi se "rezultati përfundimtar" i bisedimeve "është një Ukrainë sovranë që ecën përpara, një komb i fortë, dhe një Rusi që kurrë të mos provojë të sulmojë më". "Di një gjë për rusët në përgjithësi dhe për Putinin në veçanti: sa herë që bëhet një marrëveshje, duhet të siguroheni që është në interesin e tij që ta zbatojë", tha Rutte.

"Prandaj është shumë e rëndësishme që sa herë të arrihet një marrëveshje paqeje për Ukrainën, ai [Putin] të mos provojë më kurrë. Dhe, ai nuk do

të provojë më kurrë kur ta dijë se pasojat për të do të jenë shkatërruese nëse tenton të pushtojë përsëri Ukrainën pas një armëpushimi afatgjatë ose, më mirë, pas një marrëveshjeje paqeje".

Megjithatë, Rutte komentoi për dy aspekte të planit që kanë të bëjnë me aleancën ushtarake: dialogun e ardhshëm me Rusinë dhe anëtarësimin e mundshëm të Ukrainës në NATO.

Shefi i NATO-s, që mori drejtimin e aleancës tetorin e vitit të kaluar, tha se diskutimet e ardhshme nuk do të ndodhin nën ombrellën e Këshillit NATO-Rusi, që për herë të fundit është takuar pak para pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit 2022, ose përmes Aktit Themelues NATO-Rusi të vitit 1997, që ka kodifikuar raportet midis aleancës 32-anëtarëshe me Moskën. "Këto

gjëra janë të vdekura, këto dy institucione Këshilli NATO-Rusi dhe Akti Themelues NATO-Rusi janë të vdekura që kur Putini e pushtoi Ukrainën", tha Rutte, duke shtuar se pushtimi i shtetit fqinj nga Kremlini ishte "kundër të gjitha parimeve themelore të vlerave tona perëndimore dhe asaj që përfaqësonte Akti Themelues NATO-Rusi dhe atë që përpiqej të arrinte Këshilli NATO-Rusi".

Ngjashëm, ai nuk e përjashtoi plotësisht mundësinë e anëtarësimit të Ukrainës në NATO në të ardhmen, edhe pse në propozimin fillestar të Shteteve të Bashkuara u tha se aleanca ushtarake nuk duhej të përparonte më tej.

Megjithatë, Rutte shtoi se anëtarësimi i Kievit në NATO nuk është aktualisht në tryezë të diskutimeve. "Çdo vend brenda sferës së NATO-s - pra në zonën Euro-Atlantike që dëshiron të bëhet anëtar i NATO-s dhe ky është Traktati i Uashingtonit i vitit 1949 - mund të aplikojë për anëtarësim. Por, për t'u bërë anëtar nevojitet unanimiteti. Dhe në këtë moment, ai unanimiteti është larg që të arrihet", tha ai, duke shtuar se aktualisht janë disa aleatë që deklarojnë qartë se janë kundër hyrjes së Ukrainës në NATO.

"Sigurisht, kemi pasur edhe deklaratat nga samiti i Uashingtonit vitin e kaluar, i cili tha se ekziston një rrugë e pakthyeshme drejt NATO-s. Ky është një realitet", ka theksuar Rutte.

“ËSHTË NË DUART E GJYQITARËVE”: SPECIALJA PA DATË KONKRETE PËR VENDIMIN NDAJ ISH-EPRORËVE TË UÇK-së

HAGË, 25 NËNTOR - Dhomat e Specializuara të Kosovës nuk kanë një datë të saktë se kur do të shpallet vendimi për katër ish-udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Zëdhënësi i gjykatës me seli në Hagë, Michael Doyle, tha në një konferencë me gazetarë se, sipas rregullave, supozohet që vendimi të merret brenda tre muajsh pasi të përmbyllet procesi.

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, dhe ish-deputeti Rexhep Selimi, janë deklaruar të pafajshëm për akuzat. “Është në duart e gjyqtarëve. Por, ka afate të përcaktuara. Deklaratat përmbyllëse pritet të

përmbyllen më 13 shkurt [2026]. Rregullat thonë se gjykatësit më pas kanë 90 ditë kohë për të marrë vendimin dhe për ta shpallur atë. Pas kësaj, ka një nen edhe për një zgjatje tjetër prej dy muajsh për marrje të vendimit dhe në raste të jashtëzakonshme mund të jetë edhe më gjatë. Nuk kam arsye specifike të pres që të jetë më gjatë se kaq, por thjesht nuk e dimë. Supozimi, sipas rregullave, është tre muaj dhe nëse do të ketë zgjatje të afatit, atëherë gjykatësit do të jepen një shpjegim dhe arsye”, tha Doyle, raporton Rel.

Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi janë në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020.

Gjykimi ndaj tyre nisi në prill të vitit 2023. Fillimisht, Zyra e Prokurorit të Specializuar thirri



në gjykatore 125 dëshmitarë, ndërkaq 117 të tjerë dorëzuan dëshmitë e tyre me shkrim.

Në shtator të këtij viti, mbrojtja e Thaçit nisi paraqitjen e provave, ndërkaq ajo e

Krasniqit kishte paralajmëruar dy dëshmitarë në sallë dhe dy dëshmi me shkrim. Veseli dhe Selimi nuk do të paraqesin prova.

Në mesin e dëshmitarëve të

mbrojtjes ë Thaçit që u paraqitën në Hagë ishin kryesisht zyrtarë të lartë perëndimorë me njohuri të drejtpërdrejtë të ngjarjeve. Aty u përfshin ish-ndihmës sekretari amerikan i Shtetit, James Rubin, dhe gjenerali amerikan në pension, Welsley Clark, i cili udhëhoqi fushatën ajrore të NATO-s kundër caqeve ushtarake serbe më 1999.

Para deklaratave përmbyllëse, palët do të dorëzojnë dosjet përfundimtare deri më 30 janar. Ndërkaq, Thaçi po përballet edhe një rast tjetër për pengim të drejtësisë. Michael Doyle tha se përderisa nuk dihet ende numri i dëshmitarëve është e vështirë të dihet se sa mund të zgjasë gjykimi. Ai tha se “nuk pres” që gjykimi të jetë i gjatë sa ai për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

LDK-ja E NOMINON ABDIXHIKUN KANDIDAT PËR KRYEMINISTËR

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Lidhja Demokratike e Kosovës e ka nominuar kreun e partisë, Lumir Abdixhikun, kandidat për kryeministër të Kosovës në zgjedhjet e jashtëzakonshme të 28 dhjetorit. “Ndonëse e hapa diskutimin, nuk zgjati shumë. Ishte një diskutim i shkurtër. Kryesia e LDK-së e konsideron se përderisa ka kryetar partie nuk ka nevojë të ketë kandidat tjetër për kryeministër, prandaj më nominoj”, tha Abdixhiku gjatë një konference për media më 24 nëntor.

Abdixhiku tha se mori autorizimin për përpilimin e listës zgjedhore, por nuk do ta bëjë renditjen e kandidatëve. Ai paralajmëroi se LDK-ja do të garojë e vetme, por brenda listës do të lërë hapësirë për individë e parti të tjera, duke mos e përjashtuar as mundësinë që në të të bëjë pjesë Nisma Socialdemokrate e Fatmir Limajt.

Limaj në zgjedhjet e kaluara



garoi në një listë me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës dhe arriti të fitonte tre ulëse në Kuvendin prej 120 anëtarësh. “LDK-ja do të kujdeset që një pjesë të listës së vet ta hapë

për partitë e tjera përfshirë edhe Limajn me deputetët e vet. Për këtë çështje do të zhvillohen bisedime në ditët në vijim, por le të themi se kemi gatishmëri. Siç kemi

gatishmëri edhe për partitë e tjera që janë Demokristianët, Partinë e Drejtësisë, Aleancën e [Behgjet] Pacollit. Pra, ne jemi të hapur edhe për partitë, edhe për individët. Pra,

individë që duan të garojnë në listën e LDK-në”, shtoi Abdixhiku.

LDK-ja doli e treta në zgjedhjet paraprake parlamentare të 9 shkurtit duke fituar 18.27 për qind të votave. Në ato zgjedhje, Abdixhiku ishte po ashtu kandidat i kësaj partie për kryeministër.

Ai u bëri thirrje partive të tjera “për përbashkim”, duke thënë se ky “momentum i ri e vendos LDK-në në një pozicion përtej bazës së vetë”.

Abdixhiku tha se tani duhet “të punojmë që të mos ketë rezultat të njëjtë që më pas dërgon në bllokadë”, duke iu referuar zgjedhjeve të 9 shkurtit.

Në ato zgjedhje, Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit fitoi 42.30 për qind të votave. Por, kjo parti dështoi që dy herë të formonte një Qeveri, duke bërë që të hapej rruga për zgjedhje. LDK-ja kishte refuzuar ofertën e Kurtit për bashkëpunim në qeverisje.

Serbia thotë se ka arrestuar një ish-pjesëtar të UÇK-së

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Serbia tha të martën se ka arrestuar një ish-pjesëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të identifikuar me initiale A.Q. Sipas Ministrisë serbe për Punë të Brendshme ai dyshohet se gjatë luftës në Kosovë ka kryer veprën penale të organizimit të një grupi dhe nxitjen për kryerjen e gjenocidit dhe krimeve të

luftës.

Në njoftim pretendohet se i dyshuari në prill të vitit 1998 i është bashkuar shtabit lokal të UÇK-së për fshatin Romajë në komunën e Prizrenit dhe se si pjesëtar i brigadës 138 “Agim Ramadani” ka marrë pjesë në sulmin ndaj posti kufitar serb në Koshare në vitin 1999.

Të dyshuarit A.Q. (1973) i

është caktuar masa e ndalimit prej 48-orësh dhe MPB-ja serbe shtoi se në prokurorinë kompetente ndaj tij do të dorëzohet një kallëzim penal. Autoritetet në Kosovë ende nuk kanë reaguar për këtë pretendim të Serbisë.

Radio Evropa e Lirë i është drejtuar me pyetje Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për këtë çështje

dhe është në pritje të përgjigjes.

Viteve të fundit, në Serbi janë arrestuar disa qytetarë të Kosovës, të cilët Beogradi pretendon se kanë kryer krime të luftës.

Në korrik të këtij viti, Lulzim Halili u arrestua nga Serbia nën dyshimet për krime lufte dhe nën pretendimet se kishte qenë pjesë e brigadës



138 “Agim Ramadani” në Koshare. Atëbotë, Organizata e Veteranëve të UÇK-së, tha se emri i tij nuk figuronte në listën e veteranëve e as në atë të pjesëmarrësve në këtë betejë.



SHPËRTHIMI NË IBËR-LEPENC, NJË VIT MË VONË: AS AKTAKUZË, AS PËRGJEGJËSI

Një vit pas shpërthimit në Ibër-Lepenc, përgjegjësit ende nuk janë të qartë. Dhjetëra persona u arrestuan, por vetëm dy janë në paraburgim. Prokuroria në Kosovë konfirmon vetëm se hetimet janë duke vazhduar, por nuk jep asnjë detaj. Ekspertët - në prag edhe të zgjedhjeve të parakohshme - paralajmërojnë rreziqe të mundshme për destabilizim, por presin që KFOR-i dhe EULEX-i ta mbajnë situatën nën kontroll

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Një vit pas shpërthimit në kanalin Ibër-Lepenc, në fshatin Varragë në pjesën veriore të Kosovës, rrethanat e ngjarjes dhe përgjegjësit e saj mbeten ende të paqartë. Shpërthimi ndodhi më 29 nëntor, 2024. Kosova e cilësoi atë si një akt terrorist dhe akuzoi Serbinë për organizimin e tij, por Beogradi i mohoi këto akuza. Pas incidentit, ShBA-ja deklaroi se nuk ka prova që lidhin drejtpërdrejt Beogradin me shpërthimin dhe se është herët për të nxjerrë përfundime, por konfirmoi se në hetime janë përfshirë edhe agjentë të Byrosë Federale të Hetimeve (FBI). Prokuroria Speciale e Kosovës i tha Radios Evropa e Lirë se rasti i shpërthimit në kanalin Ibër-Lepenc është ende nën hetim dhe se nuk mund të japë detaje për të. Për Ehat Miftaraj, nga Instituti i

Kosovës për Drejtësi, është e rëndësishme që hetimi të jetë profesional dhe i bazuar në prova, “për të siguruar që ata që e kryen këtë akt të dhunshëm, të ndiqen penalisht”. Radio Evropa e Lirë pyeti edhe Prokurorinë e Lartë Publike në Beograd nëse po zhvillon hetime, pasi kryeprokurori Nenad Stefanović tha më herët se pret “një hetim gjithëpërfshirës për të zbuluar të vërtetën dhe të gjitha faktet relevante”, por, deri në publikimin e këtij artikulli, nuk mori përgjigje. Ngjashëm, as Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it nëse është i informuar për detajet e hetimit, nëse ka pasur kërkesa për bashkëpunim mes Kosovës dhe Serbisë dhe nëse pritet së shpejti ngritja e ndonjë aktakuze. Përndryshe, sulmin ndaj kanalit

të Ibër-Lepencit e dënuan vendet perëndimore, BE-ja dhe NATO-ja, të cilat kërkuan sqarimin e plotë të rrethanave dhe nxjerjen para drejtësisë të personave përgjegjës.

Çfarë është Ibër-Lepenci?

Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër-Lepenc, me seli në Prishtinë, është një ndërmarrje që furnizon me ujë të papërpunuar industrinë, ujësjellësit dhe bujqësinë, si dhe prodhon energji elektrike nga hidrocentrali i Ujmanit. Sipas faqes zyrtare të kësaj ndërmarrjeje, kompania është themeluar me vendim të Kuvendit të Kosovës më 28 shkurt, 1967. Ndërtimi i këtij sistemi u bë në dy faza: Faza e Ibrit, e cila përfundoi më 1986, dhe faza e Lepencit, e cila nuk u realizua. Kjo ndërmarrje sot është shoqëri aksionare, 100% në pronësi të Qeverisë së Kosovës.

Çfarë dihet?

Ajo që dihet deri më tani është se autoritetet e Kosovës kanë arrestuar dhjetëra persona të dyshuar për lidhje me shpërthimin në kanalin Ibër-Lepenc dhe kanë sekuestruar armë dhe eksplozivë. Megjithatë, vetëm Dragisha dhe Jovan Viçentijević janë dërguar në paraburgim. Miftaraj thotë për Radion Evropae

Lirë se vëllezërit Viçentijević ndodhen që një vit në paraburgim dhe se prokuroria duhet të jetë më efikase në punën e saj. “Prokuroria duhet ta trajtojë këtë rast si prioritar, edhe pse ende është brenda afatit ligjor prej dy vjetësh për zhvillimin e hetimeve”, thekson ai. Portali “Betimi për Drejtësi”, që monitoron rregullisht proceset gjyqësore në Kosovë, raporton se Prokuroria Speciale e Kosovës e ngarkon Dragisha dhe Jovan Viçentijevićin me veprat penale të terrorizmit, cenimit të rendit kushtetues dhe sigurisë publike, sepse ka dyshime të bazuara se ata e kanë dëmtuar qëllimisht kanalin Ibër-Lepenc me eksplozivë. Autoritetet dhe Policia e Kosovës kanë thënë më herët se janë përdorur rreth 20 kilogramë eksplozivë për të hedhur në erë kanalin dhe se ky ishte sulmi më serioz ndaj infrastrukturës kritike të vendit në periudhën pas luftës. Dëmi i shkaktuar është vlerësuar në rreth 400 mijë euro. Eksperti i sigurisë, Nuredin Ibishi, thotë për Radion Evropa e Lirë se, sipas burimeve të tij, hetimi i rastit mund të zgjasë më gjatë, për shkak se bëhet fjalë për një “rast të ndërlikuar”. “Nuk është e sigurt nëse hetimi do të përfundojë me një gjykim publik dhe nëse bëhet fjalë apo jo për një sulm terrorist ndaj infrastrukturës kritike. Ka dilema nëse hetimi do t'i zbulojë

të gjitha rrethanat. Organet e drejtësisë në Kosovë kanë qenë të hapura për bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare, me partnerët tanë strategjikë nga ShBA-ja”, thotë Ibishi.

Narrativi i politikanëve dhe akuzat e ndërsjella

Zyrtarë të lartë të Qeverisë së Kosovës kanë thënë më herët se pas sulmit qëndron ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoičiq. Radoičiq mori përgjegjësinë për sulmin e armatosur në Banjskë, në shtator të vitit 2023, kur u vra një polic i Kosovës, ndërsa në përlëshjet e armatosura që pasuan, u vranë edhe tre sulmues serbë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti - tani në detyrë - tha se ka informacione të inteligjencës se shteti i Serbisë ishte përgjegjës për financimin, planifikimin dhe logjistikën e sulmit në Ibër-Lepenc. Por, ambasadori i atëhershëm amerikan në Serbi, Christopher Hill, tha se ShBA-ja “nuk sheh asnjë provë që çon drejt Beogradit” lidhur me këtë rast. Ndërkohë, ambasadori i atëhershëm amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, konfirmoi se agjentë të FBI-së janë të përfshirë direkt në hetime. Ai theksoi se është ende herët të

MES KËRCËNIMEVE E DEBATEVE TË ASHPRA KQZ-JA MIRATON BUXHETIN PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar të martën planin e buxhetit për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 28 dhjetor 2025. Buxheti i miratuar për këto zgjedhje është 11,493,526 euro, ndërsa kostoja fillestare e planifikuar ishte 7,771,486 euro. Rritja e buxhetit përfundimtar u bë për shkak të miratimit të amendamentit që parasheh dërgimin e pakove me fletëvotime përmes postës për votuesit që janë regjistruar për të votuar jashtë vendit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka votuar të martën buxhetin për zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit, i cili është propozuar nga PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja. Ky propozim parasheh që buxhetit t'i shtohet shuma për realizimin e votimit jashtë vendit përmes dërgimit të fletëvotimeve me postë. Anëtar i Lëvizjes Vetëvendosje në KQZ, Alban Krasniqi, ka paralajmëruar se ata që mbështetën këtë propozim duhet të jenë të vetëdijshëm për pasojat në rast se bashkëqytetarët në diasporë

nuk arrijnë të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës. Sekretariati i KQZ-së dhe anëtarët e LV-së kanë insistuar vazhdimisht që votuesit në diasporë t'i fotokopjojnë vetë fletëvotimet, pa pasur nevojë që t'i presin fletëvotimet nga Kosova, duke argumentuar se nuk ka kohë për shpërndarjen e tyre. Megjithatë, vendimi nuk kaloi pa tensione mes anëtarëve të KQZ-së. Anëtar i LV-së, Alban Krasniqi, ka paralajmëruar pasojat për ata që votuan për buxhetin dhe për dërgimin e fletëvotimeve. "Një paralajmërim po ua jap të gjithëve...dijeni se jemi duke ndërmarrë veprime korruptive", ka thënë ai, duke iu

referuar dërgimit të fletëvotimeve në diasporë. Pas paralajmërimeve, Krasniqi ka lëshuar mbledhjen e KQZ-së. Anëtarët e PDK-së, Arianit Elshani dhe Ilir Gashi, kërkuar që fletëvotimet të dërgohen në diasporë në formën origjinale, sipas rregullores, ndërsa Sami Kurteshi theksoi rëndësinë e pjesëmarrjes dhe integritetit të votës. Përplasjet mes anëtarëve të LV-së, PDK-së dhe LDK-së u përshkallëzuan gjatë diskutimeve, ndërsa disa anëtarë përmendën edhe shqetësime lidhur me menaxhimin e procesit dhe

keqpërdorimin e mundshëm të fondeve. Anëtarja e KQZ-së nga komuniteti turk, Muferra Şinik, ka reaguar pas kërcënimeve të anëtarit të LV-së në KQZ, Alban Krasniqi. Şinik ka reaguar se ka pasur presion për këtë çështje, duke marrë mesazhe telefonike. Anëtar i LV-së në KQZ, Sami Kurteshi, e ka pyetur anëtarin turke në KQZ, nëse ka pasur presion nga ai. Ajo ka thënë se nuk ka pasur presion nga Kurteshi. Por, kur ky i fundit e ka pyetur, nëse ka pasur presion nga kolegu i tij Alban Krasniqi, përfaqësuesja turke nuk e ka

mohuar. Ajo ka thënë se nuk do të flas me emra. "Ai nuk është këtu, mos me pyet për emrin të lutem", ka thënë Şinik. Buxheti i planifikuar dhe miratuar për këto zgjedhje është në vlerën 11,493,526 Euro. Kostoja fillestare e planifikuar dhe prezantuar në mbledhjen e KQZ-së ishte në vlerën 7,771,486 euro. Vlera përfundimtare e buxhetit të planifikuar përfshin edhe miratimin e amendamentit të propozuar gjatë mbledhjes që parasheh dërgimin e pakove me fletëvotime në adresë të votuesve, të cilët do të regjistrohen për të votuar përmes postës. Kostoja e përafërt për dërgimin e pakove me fletëvotime përmes shërbimit postar është në vlerën e 3,722,040 dhe është llogaritur për rreth 84,000 votues potencial. Qytetarët e Kosovës do t'iu drejtohen kutive të votimit për të katërtën herë brenda 2025-tës, kur vendi t'i mbajë zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare më 28 dhjetor. Tri palë zgjedhjet e mëhershme, parlamentaret e shkurtit dhe dy rundet e zgjedhjeve lokale në tetor e nëntor, i kushtuan buxhetit të shtetit dhe partive politike rreth 23 milionë euro.

PDK-ja: Lajm i mirë nga KQZ-ja për integritetin e votimit të mërgatës

Betim Gjoshi nga PDK-ja ka thënë se bashkatdhetarëve që do të regjistrohen për votim përmes postës do t'ju dërgohen fletëvotimet origjinale në shtëpitë dhe banesat e tyre. Ai ka thënë se ky është një lajm i mirë nga KQZ-ja për integritetin e

votimit të mërgatës. "Mjeshtret e manipulimeve nga Vetëvendosje deshën që ky proces të mos ketë integritet, por të manipulohet lehtësisht duke dërguar fletëvotime me e-maile që nuk dihet në adresë të kujt do të shkojnë", ka thënë Gjoshi.



thuhet se kush është përgjegjës, por shtoi se nuk duhet përjashtuar "asnje grup apo shtet". Radio Evropa e Lirë iu drejtua Departamentit amerikan të Shtetit me pyetjen nëse FBI-ja vazhdon të jetë e angazhuar në hetim dhe nëse ka arritur ndonjë rezultat, por nuk mori përgjigje. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, ka thënë se është më pak e rëndësishme se kush e ka kryer sulmin dhe më e rëndësishme se kush qëndron pas tij. Ai e ka përjashtuar mundësinë që Rusia të jetë përgjegjëse dhe ka shprehur gatishmërinë e Beogradit për të bashkëpunuar me të gjitha organizatat dhe institucionet ndërkombëtare në hetimin e rastit. Sipas tij, nëse rezulton se një person me kombësi serbe që

gjendet në territorin e Serbisë, është përgjegjës, ai "do të arrestohet menjëherë". Vučić ka thënë, gjithashtu, se ka disa informacione se kush mund të jetë autori, por nuk ka dhënë detaje. Radio Evropa e Lirë iu drejtua edhe Presidencës së Serbisë për të sqaruar deklaratën e Vučićit dhe për të pyetur nëse Serbia është duke bashkëpunuar me institucionet ndërkombëtare apo ato të Kosovës në hetime, por nuk mori përgjigje.

Asnjë bashkëpunim ligjor

Kosova dhe Serbia nuk kanë asnjë bashkëpunim në fushën e drejtësisë. Ato i krijojnë kontaktet ose i dërgojnë kërkesa njëra-tjetrës vetëm përmes EULEX-it.

Miftaraj beson se Serbia është ajo që po shmang bashkëpunimin, jo vetëm në rastin e shpërthimit në kanalin Ibër-Lepenc, por edhe në raste të tjera. Profesoresha e pensionuar e drejtësisë nga Beogradi, Vesna Rakić-Vodineliq, i ka thënë më herët Radios Evropa e Lirë se Serbia ka shumë të ngjarë ta refuzojë bashkëpunimin me Kosovën, sepse beson se, në rast të bashkëpunimit, do të pranonte një marrëdhënie që do t'i ngjante asaj mes dy shteteve. Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, e cila u shpall në vitin 2008, dhe e konsideron atë pjesë të territorit të saj. Në vitin 2013, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, dy vendet kanë arritur një marrëveshje për

gjyqësorin, me të cilën Beogradi është zotuar se do të pranojë juridiksionin e gjyqësorit të Kosovës në komunat me shumicë serbe. Megjithatë, bashkëpunimi juridik mes dy shteteve nuk është realizuar kurrë në praktikë.

Si është situata e sigurisë?

Ibishi thotë se ekziston rreziku i një "luftë hibride", me pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore serbe. Ai nuk beson se siguria në terren mund të rrezikohet seriozisht, për shkak të pranisë së misioneve ndërkombëtare të NATO-s dhe BE-së. "Organet ndërkombëtare dhe të brendshme të sigurisë janë gjithmonë në gatishmëri për të

parandaluar çdo mundësi përshkallëzimi", thotë ai. Por, shton se ata që merren me situatën e sigurisë, duhet të jenë më të kujdesshëm në periudhën e ardhshme, duke pasur parasysh se janë shpallur zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe se ekziston një situatë e paqëndrueshme politike, me të cilën dikush "mund të abuzojë". Zgjedhjet e parakohshme në Kosovë u planifikuan për datën 28 dhjetor, pasi Lëvizja Vetëvendosje, e cila fitoi më shumë vota në zgjedhjet e 9 shkurtit, dështoi ta formonte Qeverinë e re, përkundër dy përpjekjeve. Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka përsëritur disa herë gjatë vitit të kaluar se është gati të përballet me çdo përpjekje për destabilizim.

VEPRIMTARI SALI BISLIMI PARA GJYKATËS SPECIALE NË HAGË DHE PARLAMENTIT EVROPIAN ME FOTOGRAFINË E HASHIM THAÇIT

HAGË, 25 NËNTOR - Veprimtari Sali Bislimi ka qëndruar për dy orë para ndërtesës së Gjykatës Speciale në Hagë, duke mbajtur një poster të ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. “Erdha këtu sepse jam në një mision tregues për të sensibilizuar opinionin me një manifestim personal për presidentin. Ky poster sot qëndroi dy orë afër gjykatës, ndërsa nesër do të jetë në Bruksel. Të rinjtë që kalonin pranë, me simpati brohorisnin: ‘Liri, Liri, Liri!’”, ka shkruar Bislimi në “Facebook” më 19 nëntor.

Ai shtoi se para posterit u ndalën edhe shumë punonjës të Gjykatës Speciale pas



përfundimit të ditës së punës. “Disa më falënderuan, ndërsa të

tjerë më shikonin me nervozizëm. Nuk pranonin të



bënin fotografi, por kjo zonja, në mbrojtje të Presidentit, u

ndal, bëri foto, dhe unë ia bëra një foto asaj”, ka thënë më tej Bislimi, i cili jeton dhe vepron në Zvicër.

Veprimtari Sali Bislimi pas vendosjes së posterit të ish-presidentit Hashim Thaçi para Gjykatës Speciale, ai ka vazhduar aktivitetin e tij me posterin e Thaçit edhe në sheshin ‘Grand Place’ në Bruksel dhe para ndërtesës së Parlamentit Evropian.

Ai ka përcjell edhe një mesazh para Parlamentit Evropian: “Kjo drejtësi e Gjykatës Speciale në Hagë është e manipuluar, e trafikuar dhe duhet të stopohet urgjentisht. Liri imediate Presidentit Thaçi Bashkë me shokët e tij!”, ka theksuar Bislimi në “Facebook”.

Sali Bislimi prej se çlirimtarët janë në Hagë, ka organizuar iniciativa të ndryshme ligjore për lirin e tyre.



SHKARKIMI I KELMENDIT NGA POZITA NË KPK-së: AMBASADA AMERIKANE BËN THIRRJE PËR RESPEKTIM TË LIGJEVE

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë u ka bërë thirrje të gjitha palëve në Kosovë që t'i respektojnë ligjet e vendit dhe t'i ndjekin procedurat e duhura ligjore.

Këtë qëndrim, ajo e dha për Radion Evropa e Lirë, kur u pyet në lidhje me zhvillimet e fundit në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), që kulmuan me shkarkimin e ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi.

Më 20 nëntor, anëtarja e KPK-së, Jehohna Grantolli e ka propozuar shkarkimin e Kelmendit, pas raportimeve në një media lokale në Kosovë kinse ai kishte bashkëpunuar më 1999 me një gjyqtare serbe për rastin e Masakrës së Reçakut, të cilën gjyqtarja e konsideronte ngjarje të trilluar.

Kelmendi e ka mohuar bashkëpunimin në atë rast, ndërsa vendimin për shkarkimin e tij e ka konsideruar të



paligjshëm, duke thënë se është marrë në mungesë kuorumi, prandaj do ta vazhdojë punën në këtë institucion.

Në linjë me qëndrimin e tij kanë qenë edhe disa anëtarë të KPK-së, në mesin e tyre Visar Krasniqi, sipas të cilit çdo vendim i marrë në mungesë kuorumi “është inekzistent” dhe që propozimi për shkarkimin e Kelmendit bazohet “në një energji të qartë të një puçi institucional”.

KPK-ja i ka 13 anëtarë, ndërsa për

shkarkimin e Kelmendit kanë votuar pesë prej tyre. Sipas rregulloreve, kuorumi sigurohet me gjashtë anëtarë.

Të njëjtën ditë, në vendin e Kelmendit është emëruar Agron Qalaj.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani ka thënë një ditë më parë se është duke e analizuar procesin nga aspekti ligjor dhe se është në bashkëpunim me shtetet e QUINT-it (Shtetet e Bashkuara, Britaninë e Madhe, Gjermaninë,

Francën dhe Italinë) lidhur me zhvillimet në KPK, të cilat i ka quajtur “jashtëzakonisht serioze”. “Sistemi i drejtësisë në vend është përballur për një kohë të gjatë me sfida sa i përket profesionalizmit, integritetit, pavarësisë dhe paanshmërisë. Është shumë me rëndësi që në mënyrë që deklaratat e mia të mos shihen si ndonjë ndërhyrje, sepse jam person politik që kurrë në karrierën time nuk kam ndërhyrë në sistemin e drejtësisë, që t'i lëmë vend edhe analizës së përbashkët që e kemi me partnerët tanë lidhur me procesin që ka ngjarë sa i përket shkarkimit apo tentim-shkarkimit”, ka thënë Osmani për gazetarë.

Edhe Zyra e Bashkimit Evropian ka reaguar pas këtyre zhvillimeve, duke thënë se shkarkimi i Kelmendit “pengon reformat e nevojshme në KPK dhe shpërfill parimet e ligjit”, si dhe minon përparimin e Kosovës në rrugën e saj drejt BE-së.

Kundër vendimit të marrë në KPK

kanë dalë edhe organizata të shoqërisë civile në Kosovë, përfshirë Institutin e Kosovës për Drejtësi, Grupin për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Lëvizjen FOL.

Në ditën e shkarkimit, një anëtar i KPK-së e ka akuzuar Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, se qëndron mbrapa tentimeve për ta shkarkuar Kelmendin.

Mirëpo, Prokuroria Speciale e ka mohuar ndërhyrjen e Isufajt në vendimet e KPK-së.

Më 19 nëntor, Besim Kelmendi ka dalë në një konferencë të jashtëzakonshme për media, duke i mohuar raportimet se ka bashkëpunuar me gjyqtaren serbe, Danica Marinković, më 1999, e cila e kishte përsipër rastin e masakrës së Reçakut.

Atëbotë, Marinković punonte si gjyqtare në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, dhe e kishte cilësuar masakrën si “ngjarje të trilluar”.

Në atë masakër u vranë 45 civilë shqiptarë.

HEKURUDHA E RE NË MAQEDONINË E VERIUT, NJË AMBICIE PREJ 1.9 MILIARD EUROSH

Përmes një kredie nga Britania e Madhe, Qeveria maqedonase synon të ndërtojë një “hekurudhë të shpejtë” që do përshkonte nga veriu në jug të shtetit. Projekti është paraparë të përfundojë brenda pesë vjetësh dhe trenat e pasagjerëve është thënë se do të lëvizin deri në 160 kilometra në orë. Megjithatë, kritikët thonë se kjo hekurudhë nuk do t’i sjellë përfitime Maqedonisë së Veriut, duke paralajmëruar se mund të kushtojë më shumë se kredia që është planifikuar të merret

SHKUP, 25 NËNTOR - Me investimin prej 1.9 miliard eurosh përmes kredisë së paralajmëruar nga Britania e Madhe, Qeveria e Maqedonisë së Veriut po vendos një objektiv ambicioz: brenda pesë vjetësh, hekurudhat maqedonase do të kenë një linjë moderne nga veriu në jug, nëpër të cilën trenat e pasagjerëve do të lëvizin me shpejtësi deri në 160 kilometra në orë drejt Selanikut dhe Beogradit, ndërsa trenat e mallrave me shpejtësi deri në 120 kilometra në orë. Plani është që të ruhet sa më shumë traseja ekzistuese, mbi të cilën do të ndërtohet një linjë hekurudhore krejtësisht e re dhe paralelisht me të, të vendoset një vijë e dytë, gjë që do të rezultonte në rreth 200 kilometra hekurudhë moderne dykahëshe, thotë për Shërbimin maqedonas të Radios Evropa e Lirë, drejtori i ndërmarrjes publike Hekurudhat e Maqedonisë - Transport, Sinisha Ivanovski. “Nuk do të mbajmë hekurudhën ekzistuese veri-jug. Do të ruajmë vetëm trasenë dhe do të ndërtohet një hekurudhë krejtësisht e re, sepse parametrat e asaj ekzistuese janë maksimalisht për 100 kilometra në orë dhe ajo nuk përputhet në asnjë parametër me hekurudhën për 160 kilometra në orë. Pra, e gjithë hekurudha në të dy drejtimet, me elektrifikim dhe sinjalizim, duhet të kushtojë maksimum 1.9 miliard euro”, thotë Ivanovski në një intervistë për REL-in. Sipas marrëveshjes me Qeverinë britanike, shton ai, një nga kushtet është që realizuesi i punimeve në hekurudhë të jetë një kompani britanike, e cila do të kryejë 20 për qind të vlerës totale, gjë që do të vërë në dispozicion 1.5 miliard euro për nënkontraktorë, pra kompani maqedonase. Megjithatë, Ivanovski thekson se problemi qëndron në faktin se në vend nuk ka kompani të specializuara për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e hekurudhave. Infrastruktura hekurudhore aktualisht është në një nivel shumë të ulët, me një linjë ku



trenat lëvizin maksimalisht me 50 kilometra në orë, ndërsa në disa segmente me kthesa, ku trenat madje lëvizin edhe më ngadalë se 20 kilometra në orë.

Hekurudha do të zhvillojë edhe turizmin

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Transportit i Maqedonisë së Veriut, Aleksandar Nikolloski, në nëntor njoftoi se po përgatitet ndërtimi i “hekurudhës së shpejtë” nga Shkupi në Selanik dhe, sipas tij, në këtë mënyrë shteti do të zhvillojë edhe turizmin. Ai tha se Qeveria maqedonase ka miratuar vendimin për zgjidhjen urbanistike për lokalitetin Stobi, ku po hapen gjithashtu verari në rajonin e Tikveshit. Nikolloski theksoi se qëllimi i këtyre aktiviteteve është lehtësimi i ndërtimit të kapaciteteve të reja hoteliere dhe mbajtja e turistëve që kalojnë nëpër Korridorin 10, pra rrugën E-75. Hekurudha e re që pritet të lidhë qytetet Nish dhe Shkup është në plan ndërtimi. Ajo është pjesë e projektit të Korridorit 10, i cili do të lidhë Athinën, Selanikun, Shkupin, Nishin, Beogradin,

Zagrebën, Lubjanën dhe Salzburgun. Megjithatë, një pjesë e opinionit profesional e sheh me rezerva të mëdha “hekurudhën e shpejtë” të paralajmëruar, duke theksuar se projekti po shtyhet përpara pa një analizë të mjaftueshme dhe duke paralajmëruar një rrezik potencial financiar të madh për shtetin. Profesori Dejan Trajkovski nga Universiteti "Shën Klimenti i Ohrit" e sheh projektin si “humbje” dhe, sipas tij, ai do të kushtojë shumë më tepër sesa kredia prej 1.9 miliard eurosh, madje thotë se me interesa dhe humbje të paraportuara, shuma do të arrinte në 3.3 deri në 3.5 miliardë euro. “Qeveria po përgatitet të marrë miliarda euro borxh për një projekt të falimentuar të quajtur hekurudhë e shpejtë, pa asnjë analizë ekonomike, pa studim fizibiliteti, pa debat publik, vetëm me një vendim të papërgjegjshëm politik. Ata duan një hekurudhë që do të sjellë humbje, në vend të energjisë dhe fitimeve nga Lugina e Vardarit”, thotë Trajkovski. Drejtori i Hekurudhave të Maqedonisë - Transport, Sinisha Ivanovski, thotë se aktualisht po

zhvillohen studimi i fizibilitetit, vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe studime të tjera për projektin që pritet të tregojnë mënyrën e ndërtimit të trasesë. Sa i përket leverdisë ekonomike, ai thotë se duke qenë se Maqedonia e Veriut aktualisht renditet e fundit në rajon për projektet infrastrukturore (hekurudhore dhe rrugore), pret që shteti të përfitojë nga ky projekt.

Përfitimet ekonomike

“Portet në Greqi po përjetojnë rritje të vazhdueshme të vëllimit të punës dhe rruga më e shpejtë dhe më efikase për kompanitë transportuese kalon nëpër Maqedoninë e Veriut. Sa më e shkurtër të jetë rruga, aq më të ulëta janë kostot, gjë që është përfitim i drejtpërdrejtë edhe për ne”, shpjegon Ivanovski. Nëse investimi do të kthehet plotësisht, këtë do ta tregojnë studimet, shton ai, duke theksuar se projektet infrastrukturore rrallë sjellin përfitim të drejtpërdrejtë financiar. Sipas Ivanovskit, roli thelbësor i këtyre projekteve është përmirësimi i cilësisë së jetesës dhe shërbimeve për qytetarët dhe transportin publik, i cili zakonisht subvencionohet në

të gjitha metropolet e mëdha. Më 6 nëntor, qeveritë e Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë nënshkruan një marrëveshje për ndërtimin e një tuneli hekurudhor ndërkombëtar në Korridorin 8. Tuneli i planifikuar është pjesë e Korridorit më të gjerë panevropian 8, një korridor transporti që lidh brigjet e Adriatikut dhe Detit të Zi. Traseja lidh Barin dhe Brindisin në Itali me portin e Durrësit në Shqipëri, prej nga vazhdon nëpër Ballkanin jugor drejt Bullgarisë dhe më tej deri në Varna në Detin e Zi. Rrjeti rrugor dhe hekurudhor ndjek një drejtim të ngjashëm, duke lidhur qytete kyç si Tirana, Shkupi, Sofja dhe Plovdivi. Përveç Korridorit 10, Maqedonia e Veriut pjesërisht përmes kredisë britanike, planifikon edhe rindërtimin e plotë të hekurudhës Shkup-Kërçovë, përmes Tetovës dhe Gostivarit. Kjo segment konsiderohet si zgjidhje kyç për lidhjen e ardhshme hekurudhore me Shqipërinë. Dy vendet po kërkojnë një zgjidhje për këtë, pasi traseja drejt Ohrit ndodhet në një zonë të mbrojtur nga UNESCO-ja. Lidhja me Shqipërinë do të ndërtohej brenda të paktën tetë vjetësh, thotë Ivanovski.

“Pastrimi” paralajmëron dërgimin e borxhlinjve te përmbaruesit për faturat e papaguara

Prishtinë, 25 nëntor- Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” ka njoftuar se konsumatorët që nuk i shlyejnë borxhet për shërbimin e mbledhjes së mbeturinave do të dërgohen te përmbaruesit. Në një njoftim për medie, kompania u ka bërë thirrje

qytetarëve në Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Obiliq, Drenas dhe Fushë-Kosovë që të kryejnë pagesën e faturave sa më shpejt. “Nga java e ardhshme, sikur kemi vepruar gjatë tetorit me bizneset, të gjithë konsumatorët, amvisëri, me borxhe të pashlyera do të

procedohen në përmbarim, sipas legjislacionit në fuqi. Procedurat e përmbarimit përfshijnë kosto shtesë për konsumatorët, prandaj ju ftojmë që pagesat t’i kryeni sa më herët për të shmangur shpenzime të panevojshme”, ka njoftuar “Pastrimi”.



IKJA E KAPITALIT: INVESTIMET JASHTË KOSOVËS RRIKEN PËR 55%

Investimet direkte të bizneseve kosovare jashtë vendit po rriten ndjeshëm, duke arritur në 166.6 milionë euro në gjysmën e parë të këtij viti. Kompanitë po e braktisin tregun e Kosovës për shkak të burokracisë, mungesës së digjitalizimit, kostos së lartë të energjisë dhe kushteve më të favorshme në vende të rajonit. Ekspertët thonë se largimi i bizneseve dëmton rëndë ekonominë e Kosovës, duke ulur të hyrat publike dhe duke rritur varësinë nga importet

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Bizneset kosovare po zgjerojnë gjithnjë e më shumë aktivitetin e tyre jashtë vendit, duke parë mundësi më të sigurta dhe më fitimprurëse në tregjet e rajonit.

Ky trend reflektohet qartë edhe në statistikën e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), të cilat tregojnë rritje të ndjeshme të investimeve direkte jashtë vendit.

Sipas BQK-së, gjatë gjysmës së parë të këtij viti, investimet direkte të kosovarëve jashtë Kosovës arritën në 166.6 milionë euro - një rritje prej 55% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kur shuma ishte 107 milionë euro. Për krahasim, vlera e këtyre investimeve ishte 59.1 milionë euro në vitin 2020, u rrit në 100.3 milionë euro në vitin 2021 dhe vazhdoi të ngjitej deri në 224.3 milionë euro në vitin 2024.

Shqipëria - destinacioni kryesor i investitorëve kosovarë

Një nga bizneset që e ka zhvendosur fokusin jashtë Kosovës, është kompania ndërtimore “Uni Projekt”, e drejtuar nga Fitim Bacaliu, i cili prej gjashtë vjetësh operon në Shqipëri.

Ai tregon se i ka zvogëluar investimet në Kosovë dhe i ka orientuar ato drejt tregut shqiptar. Arsyeja kryesore: fitimet më të qëndrueshme. “Në Kosovë, fuqia blerëse ka rënë ndjeshëm, ndërsa në Shqipëri ka shumë blerës të gatshëm”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Bacaliu investon deri në 4 milionë euro në vit në Shqipëri, kryesisht në Shëngjin dhe Lezhë, dhe punëson vetëm staf vendas. Thotë se ky model u ka dhënë më shumë stabilitet investimeve të tij. “Blejme toka, shesim dhe ndërtojmë objekte

të larta banimi... Vetëm unë jam nga Kosova - inxhinier. Të gjithë punëtorët janë nga Shqipëria”, shpjegon afaristi. Një tjetër rast është edhe kompania prodhuese e këpucëve “Solid Shoes” nga Suhareka, e cila prej muajit mars zotëron 40 për qind të aksioneve të një fabrike në Tiranë.

Drejtori menaxhues, Shpejtim Kuçi, thotë se zgjerimi në Shqipëri është bërë për shkak të përvojës më të madhe prodhuese, numrit më të madh të klientëve, si dhe lehtësive për eksport drejt vendeve që nuk e njohin shtetësinë e Kosovës.

Ai, po ashtu, thekson se transporti detar përmes porteve shqiptare është shumë më i favorshëm për kompanitë që synojnë tregjet ndërkombëtare. “Ka shtete ku si Kosovë hasim barriera, ndërsa Shqipëria ka marrëveshje më të hershme tregtare”, thotë Kuçi për Radion Evropa e Lirë. “Arsye tjetër është se ne synojmë edhe tregun amerikan dhe në Shqipëri tregtia mund të organizohet më lehtë për shkak të transportit detar”, shton ai.

Kompania e tij punëson rreth 600 punëtorë në Shqipëri, 200 në Kosovë dhe 80 në Preshevë. Sipas Institutit për Studime të Avancuara - GAP në Prishtinë, vetëm vitin e kaluar kosovarët investuan mbi 80 milionë euro në Shqipëri, ndërsa në vitin 2023 mbi 95 milionë euro. Në Mal të Zi, ndërkaq, investimet e tilla në vitin 2024 kapën vlerën e 18.2 milionë eurove.

Pse largohen bizneset?

Ekspertët dhe përfaqësuesit e bizneseve e shohin si shqetësuese rritjen e investimeve jashtë Kosovës. Ata paralajmërojnë se ky trend mund të intensifikohet, nëse



nuk merren masa urgjente. Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, thotë se burokracia, mungesa e digjitalizimit dhe çmimet e larta të energjisë po i shtynë bizneset drejt tregjeve të tjera. “Ne ende funksionojmë me sistem klasik. Mungesa e digjitalizimit ngadalëson proceset. Kjo e komplikon procesin për bizneset dhe ato heqin dorë”, thotë Rafuna për Radion Evropa e Lirë. Ai rikujton edhe daljen e kompanive të mëdha në tregun e hapur të energjisë, më herët këtë vit. Kjo ka bërë që çmimi i rrymës për to të shtrenjtohet dhe ato të bëhen më pak konkurruese në treg, krahasuar me vendet e rajonit.

Ismet Mulaj, ish-ministër i Tregtisë dhe Industrisë, thotë për Radion Evropa e Lirë se orientimi i bizneseve drejt Shqipërisë, Malit të Zi dhe shteteve të tjera tregon se jashtë vendit ato gjejnë kushte më të favorshme.

Sipas tij, shqetësuese është sidomos largimi i bizneseve prodhuese. “Përveç procedurave burokratike dhe problemeve me energji, imazhi

i produkteve që prodhohen në Kosovë, nuk është ai që do ta dëshironim, për shkak se edhe Kosova, edhe bizneset nuk kanë pasur fuqi financiare për të zhvilluar marketing në vendet e ndryshme”, shton Mulaj.

Çfarë humb Kosova?

Largimi i bizneseve nga Kosova ka pasoja të ndjeshme për buxhetin dhe ekonominë. Përveç daljes së kapitalit financiar, Kosova humb edhe nga të hyrat doganore, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, tatimi mbi fitimin e korporatave, si dhe tatimet dhe kontributet pensionale, të cilat përfundojnë në shtetet ku kompanitë operojnë. Për më tepër, këto biznese shpesh kthehen edhe si konkurrentë të drejtpërdrejtë në tregun vendor. “Të gjitha këto i ulin të ardhurat publike që do të mund të përdreshin për shërbime publike, qoftë për shëndetësi, arsim, infrastrukturë”, thotë Mulaj. Varësia e Kosovës nga importi, ndërkaq, vazhdon të rritet. Sipas Agjencisë së Statistikave

të Kosovës, vitin e kaluar importet kapën vlerën e mbi 6 miliardë eurove, ndërsa eksportet rreth 900 milionë euro.

Edhe këtë vit situata duket e ngjashme: nga janari deri në korrik importet kanë arritur mbi 4 miliardë euro, ndërsa eksportet vetëm 521 milionë euro. “Krejt paratë e gatshme po i nxjerrim jashtë dhe kjo është shumë e dhimbshme”, thotë Rafuna.

Ekspertët kërkojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për sektorin privat, veçanërisht për industrinë prodhuese, si dhe digjitalizim të shërbimeve përmes modelit “one stop shop”. “Nuk kërkohet ndonjë kosto e lartë për t'i realizuar shërbimet digjitale, kurse bizneset do të përfitonin shumë - qoftë në shpejtësi të shërbimit, qoftë në zvogëlim të mundësisë për korrupsion”, thotë Mulaj.

Ministria në detyrë e Industrisë, Tregtisë dhe Inovacionit në Kosovë nuk iu përgjigj pyetjes së REL-it nëse ekziston ndonjë strategji për të frenuar këtë trend të largimit të bizneseve.

Dy shtete, një komb. Përfaqësuesit e AKB-së marrin pjesë në festën e Pavarësisë së Shqipërisë

Prishtinë, 25 nëntor - Përfaqësuesit e Aleancës Kosovare të Bizneseve kanë marrë pjesë në pritjen e organizuar nga Ambasada e Shqipërisë në Kosovë në shënim të 113-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Gjatë pritjes me ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj, kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se në këtë ditë të

shenjtë për kombin tonë, 28 Nëntorin, i përulen me respekt të thellë historisë, gjakut të derdhur dhe sakrificës që solli lirinë dhe pavarësinë. “Kosova dhe Shqipëria janë dy shtete që ecin krah për krah, por një komb, një gjak, një flamur. AKB-ja mbetet e përkushtuar që ky bashkim shpirtëror dhe historik të shndërrohet në bashkim ekonomik, në

zhvillim të përbashkët dhe në një treg të fuqishëm mbarëkombëtar. Është nder për ne që në këtë ditë të madhe të jemi pranë institucioneve të Shqipërisë dhe pranë përfaqësuesit të saj diplomatik në Kosovë, bashkë me Shkëlzen Jusaj, Haziz Tafa, Lumni Ajdini dhe Arber Pajaziti kryetar i Komunës së Bujanocit”, ka thënë Shahini.



“THE QUEBEC CHRONICLE” (1910): SHQIPTARI I HUTUAR



The Quebec CHRONICLE, 19 prill 1910 (artikulli *The perplexed Albanian*)
Përktheu: Jeta Toçila DEDJA

Një gjuhë pa alfabet. Ndërsa pjesa më e madhe e Evropës po ankohet ndaj bollëkut të librave dhe përmbytjes me fjalë të printuara, shqiptarët, një nga popujt më të vjetër të kontinentit, po ulërijnë për mjetin më elementar të shprehjes - alfabetin.

Në këtë vend të thjeshtë, pa alfabet, ku fëmijët nuk u shqetësuan kurrë për ABC-në e gjuhës që folën, ku krijuesit nga majat e maleve nxorën historitë e tyre më të bukura, e poetët kënduan më të ëmblat vargje, duke i rënë çiftelisë në kullat e zjarrit, Turqia ka mbjellë farat e kulturës dhe palumturisë.

Ky ndryshim i kushteve idilike u soll kur qeveria vendosi së fundmi lejimin e mësimin të gjuhës shqipe në shkollat shtetërore.

Fillimisht, vendimi u prit me hare dhe festime, por më pas pikëpyetje u ngritën: Si do të mësohet gjuha pa një alfabet? Gjuha shqipe, përgjithësisht është konsideruar po aq e vështirë të zbutet e ndrydhet ne faqe librash sa ç'janë edhe njerëzit për t'u qeverisur.

Është gjuha më e vjetër në Ballkan që i rezistoi dyndjeve sllave. Parimet e saj kryesore përputhen me sistemin e gjuhëve evropiane ariane dhe disa principe afrojnë

në detaje me greqishten.

Shqipja ka mbijetuar si gjuhë e folur e megjithatë për shumë shqiptarë që dinë të shkruajnë e lexojnë lehtësisht shumë gjuhë të tjera, nëse do e shihnin të printuar gjuhën e tyre, nuk do ta kuptonin.

Përpjekje të shumta janë bërë për ta kthyer shqipen ne gjuhë të shkruar. Një nga arsyet e arritjeve të sukseseve të niveleve të papërfillshme ka qenë vështirësia për të prodhuar karaktere që do të përfaqësonin tingujt. Më tej, gjetja e gjuhës së përbashkët mes përfaqësuesve të besimeve të ndryshme fetare mbi përcaktimin e shkronjave.

I fundit që është përpjekur ka qenë Kostandin Kristoforidhi, i cili publikoi një gramatikë të dobishme të të dy dialekteve, tosk dhe geg, si dhe përktheu Biblën në toskërisht.

Si konkluzion i gjithë orvatjeve për alfabet, deri tani janë paraqitur katër modele. I pari është një alfabet me shkronja greke. I dyti, bazuar në modelin e Kristoforidhit, paraqitet me germa greke dhe latine dhe me shumë shenja diakritike. I treti përdor shkronja latine dhe i katërti është një variant i çuditshëm dhe i shëmtuar i shkronjave greke dhe latine së bashku.

Por, tani që turqit kanë njohur të drejtën e shkollimit në gjuhën shqipe, ata po insistojnë që të përdoret alfabet arab dhe hoxhallarët reaksionarë po



çalltisin të bindin fiset e myslimanëve duke u thënë se ky është i vetmi alfabet i lejuar për muhamedanët e mirë.

Duhet thënë se nga gjithë alfabetet e propozuar, ai arab duket më pak i përshtatshmi, sepse shqipja afron ose me greqishten ose latinishten, dhe për më tepër tentativat për të shkruar shqipen me shkronja arabe kanë rezultuar në hieroglifë që edhe vetë

shkrimtarët nuk mund t'i deshifrojnë.

Kështu, me kaq variante për të zgjedhur, shqiptari i hutuar i drejtohet për udhëzime të mëtejshme këshilluesve fetarë. Takime të shumta janë mbajtur në gjithë vendin për të diskutuar mbi këtë çështje. Shkupi, Prishtina dhe Mitrovica, seksionet myslimane, pra, kanë votuar për shkronjat arabe. Korça toske dhe Elbasani geg -

seksione katolike romane, janë deklaruar në favor të germave latine. Ndërkohë, tensionet janë rritur dhe shumë gjak po derdhet për alfabetin.

Në këtë mënyrë, shqiptari ka arritur atë që do, një shkak për të luftuar; por, shkolla të reja shtetërore nuk ka të hapura dhe gjuha shqipe ende nuk po mësohet në ato që ekzistojnë vetëm se thjesht duhet një alfabet.

KOSOVA ISHTE ME FAT QË E KISHTE SHQIPËRINË NËNË DHE AMERIKËN ALEATE - PRANDAJ ËSHTË E ÇLIRUAR NGA SERBIA PUSHTUESE



Shqipërisë Nënë!
Të nderuar të pranishëm!
 Nëntori i Flamurit të Skënderbeut në Krujë!
 Nëntori Alfabetit të Shkronjave të Gjuhës Shqipe në Manastir të Maqedonisë së Veriut!
 Nëntori i Flamurit e i Pavarsisë së Shqipërisë në Vlorë!
 Nëntori i çlirimit të Tiranës se kuqe dhe i gjithë Shqipërisë heroike në Luftën e Dytë Botërore, është muaji i lavdishëm, të cilin e kanë furnizuar dhe e kanë pasuruar edhe shqiptarët jashtë Shqipërisë në përgjithësi dhe Kosova

Zvicër, nga Kryesia e Lëvizjes Popullore të Kosovës, u themelua edhe de jure dhe u emertua Ushtria Çlirimtare e Kosovës!
 Po atë ditë me 17 Nëntor 1994 u vendos që trupa komanduese e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të quhej Shtabi Qendror i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!
 Gjithashtu më 17 Nëntor 1994 doli Komunikata e e parë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me nr. 11!
 Dhe po më 17 Nëntor 1994, iu vu pseudonimi i parë dhe i fundit Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Uskana!
 Më 28 Nëntor 1997, Ushtria

Kosova ishte me fat që e kishte Shqipërinë Nënë përkrahëse të vazhdueshme në rrugën e saj të lirisë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës aleate- prandaj duke qenë se ishte në akord të plotë me Nënë dhe aleaten e madhe, është e çliruar nga Serbia pushtuese!
 Kosova ishte dhe do të mbetet pjesë aktive në proceset e mëdha kombëtare me Nënë Shqipërinë!
 Në ballë të nëntorëve në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni të Veriut, në Luginë të Preshevës, në Mal të Zi dhe kudo ku jetojnë shqiptarët, valëvitet i njëjti flamur që është i



Ismet SYLEJMANI

Të dashura motra e vëllezër nga Tirana dhe nga e gjithë Shqipëria, mirë se ju gjej dhe ju sjell përshëndetje nga Kosova!
 Jam me shumë fat që sot gjendem në mes jush dhe gjithashtu kamë knaqësinë e madhe të ju drejtohem me një fjalë rasti, me

rastin e festave të 28 e 29 Nëntorit!

I nderuar Kryetar Hako,
I nderuar Sekretar i Përgjithshëm Myftari,
I nderuar shoku e bashkëluftëtari im dr. Gani Morina,
Të nderuar veteranë e pasardhës të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të popullit shqiptar të

liridashëse e lavdimadhe në veçanti!

Në Kosovë në muajin Nëntor të vitit 1989 dherdhi gjakun e Tij në Breg të Diellit ne Prishtinë Udhëheqësi i Lëvizjes Popullore të Kosovës, Afrim Zhitia, bashkë me bashkëveprimtarin e Tij, Heroin e Kombit Fahri Fazliun!
 Në muajin Nëntor, më datën 17, të vitit 1994 në Qytetin Arau në


Çlirimtare e Kosovës, doli publikisht në Llaushë të Skenderajt në Drenicë, në varrimin e mësuesit Halit Geci, i vrarë nga forcat pushtuese serbe!

Të nderuar të pranishëm!
 Nëntorët e Kosovës, të gjithë pa përjashtim ishin të ndikuar thellësisht nga nëntorët e Nënë Shqipërisë!

rëndë sa toka dhe është i qullur me gjak lirie, këndohen të njëjtat këngë, përkulen mijëra e miliona koka para të njëjtëve heronj!
 Lavdi nëntorëve të lavdishëm të kombit tonë!
 Lavdi gjakut të derdhur për liri të Heronjëve dhe Dëshmorëve të Atdeut!
 Rroftë populli shqiptar!

Tiranë, 22 Nëntor 2025





Prishtina 01 vazhdon me rezultate pozitive në UEFA Futsal Champions League

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Në ndeshjen e parë të fazës së 16 më të mirëve të UEFA Futsal Champions League, Prishtina 01 ka treguar një tjetër paraqitje

dinjitoze, duke barazuar 3:3 përballë kampiones së Letonisë, Riga FC në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Golat për Prishtinën 01 i kanë

shënuar Drilon Maxharraj (6', 10') dhe Ramadan Alaj (34'), derisa golat për Riga-n i kanë shënuar Viktors Kulepovs (19'), Daniel Airoso (32') dhe Jose

Marquardt (38'). Tani gjithçka mbi kualifikimin në çerekfinale do të vendoset në ndeshjen e kthimit, që zhvillohet më 5 dhjetor në Riga.



AFRIM TOVËRLANI EMËROHET TRAJNER I PRISHTINËS

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Afrim Tovërlani është trajner i ri i Prishtinës, pasi klubi nga kryeqyteti të martën ka bërë prezantimin e tij. Tovërlani në këtë post e zëvendëson Arsim Thaqin, i cili është larguar të hënën nga klubi. "FC Prishtina ka kënaqësinë ta prezantojë trajnerin e ri të skuadrës, Afrim Tovërlanin, i cili pas 11 vitesh rikthehet në krye të bardh e kaltërve. "Toki" kthehet në shtëpinë e tij, aty ku ka lënë gjurmë të thella si futbollist dhe trajner", ka njoftuar Prishtina. Tovërlani më herët e ka

udhëhequr FC Prishtinën në dy periudha të ndryshme, 2007-2009 dhe 2012-2014, duke arritur rezultate mbresëlënëse. Gjatë katër viteve në drejtimin e klubit, ai i ka dhuruar Prishtinës 7 trofe, përfshirë titullin e kampionit, Kupën e Kosovës dhe Superkupën, duke u renditur ndër trajnerët më të suksesshëm në historinë moderne të klubit. Përveç arritjeve si trajner, Afrim Tovërlani ka një histori të pasur edhe si futbollist i FC Prishtinës. Klubi i ka uruar mirëseardhje Tovërlanit, me

besimin se përvoja dhe profesionalizmi i tij do t'i rikthejnë klubit lavdinë dhe trofetë që tifozët i presin me entuziazëm. Tovërlani, aktualisht është selektor i Kosovës U21, ndërsa si trajner ka punuar edhe te Trepça '89, Ferizaj dhe Feronikeli. Ai pritet të debutojë në krye të Prishtinës këtë vikend, në ndeshjen kundër Prishtinës së Re. Prishtina prinë në Superligë me 26 pikë dhe është në seri prej katër ndeshjeve pa fitore, ku ka regjistruar dy barazime e dy humbje.



LOJËRAT MESDHETARE NË KOSOVË ZHVILLOHEN NË 24 DISIPLINA SPORTIVE

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030 do të presin një gamë të larmishme prej 24 disiplinash sportive, me mundësi që ky numër të zgjerohet edhe më shumë. Nga këto, 21 i përkasin kategorisë prestigjioze të disiplinave olimpikë, ndërsa 3 janë disiplina jo-olimpikë. Këto disiplina përfshijnë një gamë të gjerë talentesh, nga aftësitë individuale te ekselencia kolektive, duke përfaqësuar natyrën shumëdimensionale të atletikës. Nga lista e 24 sporteve që do të



jenë pjesë e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, Kosova është krenare të ketë federata të konsoliduara kombëtare për 21

nga këto disiplina, të gjitha të njohura ndërkombëtarisht nga organet përkatëse qeverisëse. Duke u përqendruar tek tre

sportet e mbetura, noti me palë përfin, noti në kanoë/roning dhe bowls, Kosova ka shprehur gatishmëri të përballet me këtë sfidë me vendosmëri. Ndërkohë që federatat kombëtare aktualisht mungojnë për këto sporte, Kosova ka shprehur gatishmëri për të krijuar kapituj të rinj në historinë sportive. Në librin e zotimeve, Kosova është zotuar se do të krijojë me përkushtim federata kombëtare për notin me palë përfin, rowing dhe bowls, duke siguruar që këto disiplina të integrohen në mënyrë të qetë në peizazhin

sportiv dhe të zhvillohen me të njëjtin pasion dhe rigorozitet si ato të njohurat. Kjo është lista e plotë e disiplinave sportive që do të zhvillohen në Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030": Gymeti (harkëtaria), atletikë, boks, çiklizëm, skermë, futsal, gjimnastikë, xhudo, kanotazh (vozitje), lundrim (me vela), qitje, not, not me pina (nofinot), polo në ujë, tenis, peshëngritje, boçe, pingpong, karate, basketboll 3x3, hendboll, volejboll, taekwondo dhe mundje.

DORTMUNDI NË GARË PËR ASLLANIN



DORTMUND, 25 NËNTOR - Borussia Dortmundi po sfidon Bayern Munchenin e Barcelonën për shërbimet e sulmuesit të Kosovës, Fisnik Asllani. Mediumet gjermane, kanë raportuar të martën se Dortmundi po synon

transferimin e Asllanit me të përfunduar sezoni aktual. Asllani këtë sezon po shkëlqen në Bundesligë me fanellën e Hoffenheimit, ndërsa ka tërhequr vëmendjen e shumë skuadrave tjera. 23-vjeçari po shihet te

Dortmundi si pasardhës i Serhou Guirassy, i cili pritet të largohet në verë. Asllani ka kontratë deri në vitin 2029 me Hoffenheimin, ekip që për kartonin e tij po kërkon 30 milionë euro. Nëse Asllani largohet për këtë çmim në

verë, atëherë do të ishte njëri prej pesë shitjeve më të shtrenjta në historinë e Hoffenheimit. Në 13 ndeshje të luajtura këtë sezon për Hoffenheimin, Asllani ka shënuar 6 gola dhe ka bërë 3 asistime.

Granit Xhaka, përforcimi më i mirë i sezonit në Premier League

SUNDERLAND, 25 NËNTOR - Ylli shqiptar i futbollit, Granit Xhaka është duke u vlerësuar si blerja më e mirë e sezonit në Premier League pas paraqitjeve

të jashtëzakonshme me Sunderland. Mesfushori shqiptar, i transferuar nga Bayer Leverkusen për rreth 17 milionë paund, ka bërë një


ndikim të menjëhershëm te skuadra e sapongjitur në elitë. Sipas "Sky Sports", Xhaka ka fituar më së shumti vota në sondazhin për blerjen e

sezonit, duke lënë pas emra të mëdhenj. Ai ka sjellë stabilitet, përvojë dhe lidhshëm në mesfushë, duke kontribuar në sukseset e skuadrës.





Ndërmarrja Publike Lokale NPL Eko Natyra Sh.A Skenderaj



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenin 20 dhe nenin 22 të Rregullores Nr. 056/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të N.P.L. "Eko Natyra" Sh. A. e miratuar me datë 16.06.2025 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Eko Natyra" Sh. A, si dhe Plotësim Ndryshimi i Rregullorës për Organiimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës Nr.275/25 të datës 19.09.2025, e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 351/25 të datës 21.11.2025 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Eko Natyra" Sh. A, me datë 25.11.2025 shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Pastrues/e i/e Zyrave dhe Objekteve

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla fillore

Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune

I raporton: Udhëheqësit të Njësies së Mirëmbajtjes – Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve

Koeficienti i pagës: (350) Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta.
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim.
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga eprori.
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së eprorit.
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave të menaxhmentit të ndërmarrjes.
- Për punën e tyre i përgjigjet Udhëheqësit të Njësies së Mirëmbajtjes – Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Eko Natyra" Sh. A - Skenderaj. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (E skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (Certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (Certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative), duke i bashkëngjitur CV);
- Kopjen e letërnjoftimit (E skanuar);

II. Titulli: Shofer

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkollim të mesëm

Përvoja e punës: Preferohet një (1) vit

I raporton: Kryeshefit Ekzekutiv.

Koeficienti i pagës: (425) Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Drejton dhe kujdeset për automjetin.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e automjetit, larjen, lyerjen, evidentimin e prishjeve etj.
- Drejton dhe mirëmban sipas nevojës edhe automjetet tjera të ndërmarrjes.
- Në fletudhëtim regjistron numrin e kilometrave të kaluara dhe shënimet tjera, të cilat kërkohen.
- Paraqet çdo defekt dhe dëmtim të shkaktuar në automjet dhe bën arsyetimin e shpenzimeve të derivateve dhe kilometrave të kaluara.
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Eko Natyra" Sh. A - Skenderaj. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Jetëpërshkrimi;
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara)
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

III. Titulli: Elektrici

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme

Përvoja e punës: Preferohet një (1) vit në fushën përkatëse

I raporton: Mbikqyrësit të Punëve Operative në Teren.

Koeficienti i pagës: (550) Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Është përgjegjës për punët që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e ndriçimit publik.
- Zbaton detyrat dhe aktivitetet operative të përcaktuara nga udhëheqësi i tij.
- Është përgjegjës për mirëmbajtjen e ndriçimit, si dhe punët tjera të elektrikes në ndërmarrje.
- Mban përgjegjësi për materialin e shpenzuar, si dhe shpenzimet e materialit i shënon në dëshmitë përkatëse sipas dokumentacionit të N.P.L.
- Për punën e vet i përgjigjet Mbikqyrësit të Punëve Operative në Teren.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Eko Natyra" Sh. A - Skenderaj. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Jetëpërshkrimi;
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojnë të paktën një gjuhë zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimi.
- Certifikatën shëndetësore.

Periodha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 25.11.2025 deri me datë 09.12.2025 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 16.12.2025.
- Afati për ankesë nga data 17.12.2025 deri me datë 19.12.2025.
- Periodha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 30.12.2025.
- Afati për ankesë nga data 31.12.2025 deri me datë 06.01.2026.
- Periodha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 13.01.2026.
- Afati për ankesë nga data 14.01.2026 deri me datë 16.01.2026.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 21.01.2026.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L. "Eko Natyra" Sh. A në qytetin e Skenderajt, rr. "Ali Gashi" çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do t'u asistoj dhe t'u jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: eko.natyra2021@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Përfundim

N.P.L. "Eko Natyra" Sh. A në Skenderaj ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1903

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

